

VENDIM
Nr. 131, datë 7.3.2018

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE, NGA FONDI REZERVË I
BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2018, PËR PROJEKTET DHE AKTIVITETET NË
KUADËR TË VITIT MBARËKOMBËTAR TË GJERGJ KASTRIOTIT - SKËNDERBEUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, t’i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2018, për projektet dhe aktivitetet në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama